

# • HISTORIA E SHQIPTARËVE •

---

Erdha në jetë. Sa shpejt u krijova, aq shpejt u shkatërrova, këtë Botë kështu nuk e mendova, për kohë të gjatë sytë verbova që këtë mizori të mos përjetoja, por u gabova dhe shigjeta në shpirt mora. Para meje shuheshin jetë të rinjve, të moshuarve, foshnjave e adoleshentëve. Shumë rrugë jete u dogjën dhe tymi mushkритë rropën, si mund të ish' kjo jetë kaq e pashpresë me këtë ndriçim të pabesë. Pse Dielli duhet të lindë që të perëndoj, e me atë perëndim, jetët të mbarojnë? Shumë frymë jepen sot, që egoja e nazistëve të rritet plot. Ah, moj jetë, sa mizore pasqe qenë! Në do të dija të tillë, jetën e kisha lënë.. Si mundesh të më bësh të vuaj?! Zemrën copash të ma shkruash, para syve familjarët të m'i gjuash e fjalët të mos i kursesh, se shpirti jot kështu paqe gjen.

Dikush nga ty do të shpëtojë, por kurrë nuk mundet larg të shkoj, grabiqarin me vrap e dërgon, që këtë zemër të lëkundur, botën t'ia shkatërrojë. Hans Bonarewitz prej kafazit fluturoi, e ushtari urdhëroi, hienat gjakatare mbrapa t'i shkojnë. Ah, more Hans, kjo jetë s'qe për ty! Aty ku pakëz dritë shikove, gjahtarit plumbin ia dërgove, për të çpuar plagët përtej, se mbase ai plumb shpresa qe vërte. Paqe në këtë botë nuk pe, por shpresojm që aty ku tashmë je, të marrësh frymë lirisht shpresojm ne. Se këta të pashpirtët nazistë tokën lanë me gjak, se shpirti s'jua pranonte shpirtbardhët e larë. Kaq të pashpirt qenë, sa ekzekutimin në mes popullit ta bënë, me orkestrën që notat t'i lëshonte si gjëmb.

Gur në vend të zemrës këta nazistët patën, aq sa tek zemrat e secilit frikën mbollën për të ardhmen. Kush fjalë jasht libri, nuk thoshte, se në kampet gjakatare do të përfundonte apo përballë një popull të tërë, shteti do e ekzekutonte, aq sa edhe pema larg fëshërinte. Kjo botë tashmë përmes televizorëve të parë, arrihej të shihej. Ngjyra më nuk kishte. Dielli pendohej që lindte. Oksigjeni mallkonte veten që çlirohej e betoni donte të mos ekzistone. Zjarri, Prometeun luftonte, se pse e solli në jetë, se me këtë gabim do të digjej e vetë.

500 shqiptarë në Mauthausen u dërguan e 427 në ato toka u mërguan, shtratin e vdekjes atje e gjetën mbi flakët që flakërijnë urrejtjen e jetës. E kjo mizori jo vetëm atje mori ekzistencë, edhe në tokat shqiptare hapsirën gjen. Masakra të pazemërta shkaktoi, që trauma të pafundme nga ato tërmete të shkaktojë. Ja ku ndodhet Jorgjie Stillo, një 7 vjeçare para 107 luleve të thara, ku rrënjët nga toka u kishin shkukur e zemra u qe këputur. Në këto 107 lule, 5 qenë të sajat. I ati, vëllai, e ëma, motra e vëllai i vogël perënduan në 6 korrik 1943, në Borovë, nga gjermanët që bëjnë terror. Në sytë e asaj vajze oshëtiu pistoleta, 5 shtrëngata vazhdojnë të furijnë në trurin e asaj vajze të shkretë. Edhe sot e kësaj dite kur për këtë ngjarje bëhet fjalë, buza i dridhet sikur dita e parë.

Gjithë ky mallkim mbi jetë të pafajshme ranë. Pasardhësve të viktimave shpirtin iua thanë. Pa foshnja nazistët djepet i lanë. Ditët e errëta ikën e fundi dukej larg, zi mbahej në shpirt, vajtohej prag më prag. Por shpresa s'u shua e jeta vazhdoi, liria kish' ardhur e krimet naziste dënoi. Sot thotë njerëzimi këmbëkryq këtu jam, në emër të jetës popujt besëlidhur i kam. Mbi çdo gjë sot është dinjiteti njerëzor. Jo më Mauthausen e viktimë theror!

**PUNOI: ALTEA HYSOLLARI**  
**GJIMNAZI: "SAMI FRASHËRI"**  
**KLASA: 12-10**